

VENDIM
Nr. 193, datë 26.3.2026

**PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE SPECIFIKE PËR TRANSFERIMIN OSE
DHËNIEN ME QIRA TË TË DREJTAVE TË PËRDORIMIT TË FREKUENCAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 71, të ligjit nr. 54/2024, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullave specifike për transferimin ose dhënie me qira të të drejtave të përdorimit të frekuencave, sipas rregullores që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

RREGULLA SPECIFIKE
PËR TRANSFERIMIN OSE DHËNIEN ME QIRA TË TË DREJTAVE
TË PËRDORIMIT TË FREKUENCAVE

Neni 1
Qëllimi

1. Kjo rregullore përcakton rregullat specifike për transferimin ose dhënie me qira të të drejtave të përdorimit të frekuencave ndërmjet subjekteve të autorizuara nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), sipas parashikimeve të ligjit nr. 54/2024, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”.

2. Qëllimi i kësaj rregulloreje është sigurimi i përdorimit efikas të spektrit të frekuencave, në përputhje me objektivat e politikës nëpërmjet një procesi transparent e jodiskriminues, në mbrojtje të konkurrencës në treg, të interesit publik, të sigurisë kombëtare dhe të rendit publik.

Neni 2
Përkufizime

Përveç përkufizimeve të dhëna në nenin 4, të ligjit nr. 54/2024, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, për qëllime të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “**Transferim**”, kalimi nga një mbajtës i të drejtave të përdorimit të frekuencave (“transferuesi”) të një pjese ose të të gjitha frekuencave, të dhëna në përdorim nga AKEP-i, në bazë të një autorizimi individual, te një palë tjetër (“përfituesi”), ku transferuesi heq dorë nga çdo e drejtë e përdorimit të frekuencave, objekt i transferimit;

b) “**Dhënie me qira**”, dhënie në përdorim nga një mbajtës i të drejtave të përdorimit të frekuencave me autorizim individual (“qiradhënësi”) të një pjese ose të të gjitha frekuencave/të

drejtave individuale të përdorimit të frekuencave, të dhëna nga AKEP-i, në bazë të një autorizimi individual, të një palë tjetër (“qiramarrësi”), ku qiradhënësi mbetet përgjegjës për plotësimin e të gjitha kushteve të autorizimit individual, përfshirë pagesën e tarifave, ndërsa qiramarrësi mban përgjegjësinë për kushtet teknike të përdorimit;

c) “**Kushte teknike**”, kushtet e autorizimit individual me karakter teknik lidhur me kushtet se si mbajtësi i autorizimit individual ruan, zotëron, instalon, mirëmban, përdor e operon pajisjet, që janë subjekt i autorizimit individual për përdorimin e frekuencave;

ç) “**Procedurë standarde**”, procedura e shqyrtimit dhe e vlerësimit me dy faza nga AKEP-i të një kërkesë për transferim apo dhënie me qira të të drejtave të përdorimit për autorizimet individuale, ku rreziku i shtrembërimit të konkurrencës konsiderohet i lartë, sipas përcaktimeve në nenin 72, të ligjit nr. 54/2024, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”;

d) “**Procedurë e thjeshtuar**”, procedura e shqyrtimit dhe e vlerësimit nga AKEP-i të një kërkesë për transferim ose dhënie me qira të të drejtave të përdorimit të frekuencave të dhëna nga AKEP-i, në zbatim të nenit 66, të ligjit nr. 54/2024, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, kur rreziku i shtrembërimit të konkurrencës konsiderohet i ulët.

Neni 3

Parime të përgjithshme

1. Transferimi ose dhënia me qira e të drejtave të përdorimit të frekuencave bazohet në parimet e ligjshmërisë, të objektivitetit, të transparencës, të mosdiskriminimit e të konkurrencës së ndershme.

2. Transferimi ose dhënia me qira e të drejtave të përdorimit të frekuencave lejohet vetëm me miratimin paraprak të AKEP-it, në përputhje me objektivat e përgjithshëm politikë të përcaktuar në nenin 5, të ligjit nr. 54/2024, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” në vijim, ligji nr. 54/2024), si dhe objektivat e politikës spektrale.

3. Transferimi ose dhënia me qira e të drejtave të përdorimit të frekuencave synon përdorimin sa më efikas e racional të spektrit, duke nxitur konkurrencën dhe zhvillimin e qëndrueshëm të tregut të komunikimeve elektronike.

Neni 4

Kërkesat për transferimin ose dhënien me qira të frekuencave

1. E drejta e transferimit ose e dhënies me qira e të drejtave të përdorimit të frekuencave bëhet me iniciativën e mbajtësit të tyre, sipas përcaktimeve në nenin 71 të ligjit nr. 54/2024.

2. Nga procedura e transferimit ose e dhënies me qira në përdorim të frekuencave përjashtohen rastet e parashikuara në pikën 2, të nenit 71, të ligjit nr. 54/2024.

3. AKEP-i miraton transferimin ose dhënien me qira të të drejtave të përdorimit, kur përmbushen kërkesat për transferim, sipas pikës 5, të nenit 71, të ligjit nr. 54/2024.

4. AKEP-i refuzon transferimin ose dhënien me qira të të drejtave të përdorimit, kur:

a) transferimi ose dhënia me qira bie ndesh me rregullat e konkurrencës, sipas përcaktimeve në nenin 72, të ligjit nr. 54/2024, përfshirë:

i. ndikimin e mundshëm negativ në tregun e shumicës e të pakicës për komunikimet elektronike;

ii. rritjen e përqendrimit të spektrit në një sipërmarrës;

iii. rritjen e mundshme të çmimeve në treg, për shkak të transferimit apo dhënies me qira dhe nga efektet e veprimit të njëanshëm;

iv. rritjen e pengesave hyrëse në treg;

v. ndryshimet e mundshme në cilësinë e ofrimit të shërbimeve pas transferimit.

b) transferimi apo dhënia me qira ndikon negativisht në funksionimin e rrjeteve ekzistuese të komunikimeve elektronike;

c) transferimi apo dhënia me qira cenon menaxhimin efikas të spektrit;

ç) preken interesat publikë, siguria kombëtare, rendi publik ose shëndeti publik;

d) në autorizimin individual është përcaktuar që të drejtat e përdorimit nuk janë të transferueshme.

5. AKEP-i, me marrjen e njoftimit fillestar për synimin e një transferimi apo dhënieje me qira të së drejtës së përdorimit nga mbajtësi i tyre, ndërhyr për të parandaluar:

a) përqendrimet të tepërta të spektrit të një sipërmarrës ose subjekte të lidhura ekonomikisht;

b) krijimin apo forcimin e pozitave dominuese të një sipërmarrësi;

c) pengimin e hyrjes së operatorëve të rinj në treg.

6. Të gjitha kushtet teknike, detyrimet dhe kufizimet e parashikuara në autorizimin individual fillestar mbeten të vlefshme dhe detyruese edhe pas kryerjes së transferimit apo dhënies me qira të të drejtave të përdorimit të frekuencave.

7. Transferimi i së drejtës nuk nënkupton automatikisht transferimin e detyrimeve, që lidhen me autorizimin individual. Përcaktimi i detyrimeve bëhet nga AKEP-i në vendimin e miratimit.

Neni 5

Aplikimi për transferim ose dhënie me qira

1. Aplikimi për miratimin e transferimit ose të dhënies me qira të të drejtave të përdorimit të frekuencave bëhet bashkërisht nga palët e interesuara, sipas formularëve të miratuar nga AKEP-i për transferimin ose dhënien me qira të të drejtave të përdorimit të frekuencave.

2. Aplikimi për transferimin ose dhënien me qira të të drejtave të përdorimit të frekuencave kalon në këto faza:

a) njoftimi fillestar për synimin e një transferimi apo dhënieje me qira;

b) njoftimi zyrtar;

c) verifikimi paraprak dhe vlerësimi nga AKEP-i;

ç) vendimi i AKEP-it.

3. AKEP-i miraton formularin e aplikimit për njoftimin zyrtar të transferimit ose dhënien me qira të të drejtave të përdorimit të frekuencave.

Neni 6

Njoftimi fillestar

1. Palët që synojnë të realizojnë një transferim apo dhënie me qira të të drejtave të përdorimit të frekuencave njoftojnë së pari AKEP-in nëpërmjet një njoftimi fillestar.

2. Njoftimi fillestar përmban një informacion të përgjithshëm mbi synimin për transferimin ose dhënien me qira të të drejtave të përdorimit, të dhëna sipas autorizimit individual të referuar në këtë njoftim, që paraqitet nga mbajtësi i së drejtës së përdorimit ose bashkërisht nga palët e interesuara.

3. Me marrjen e njoftimit fillestar për synimin e një transferimi apo dhënieje me qira të të drejtave të përdorimit, AKEP-i shqyrton, brenda 10 (dhjetë) ditëve punë, nëse transferimi i të drejtave të përdorimit të frekuencave është i lejuar dhe, në përfundim të këtij afati, u kthen përgjigje palëve të interesuara, duke informuar për kërkesat për vijimin ose jo të transferimit ose të dhënies me qira, sipas përcaktimeve ligjore.

4. Gjatë shqyrtimit të njoftimit fillestar, AKEP-i mund të kërkojë sqarime shtesë lidhur me kërkesat përkatëse të autorizimit individual, për të cilin synohet transferimi ose dhënia me qira e

të drejtave të përdorimit të frekuencave të propozuar. Në këtë rast, sipërmarrësi depoziton informacionin e kërkuar jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë pune nga kërkesa e AKEP-it për sqarime.

5. Në rastin kur transferimi ose dhënia me qira e së drejtës së përdorimit është e lejuar, AKEP-i kthen përgjigje dhe udhëzon për dokumentet, që duhet të paraqiten me njoftimin zyrtar.

6. Në dhënien e përgjigjes për njoftimin fillestar, AKEP-i mban parasysht parashikimet e nenit 4 të kësaj rregulloreje për rastet e refuzimit të transferimit ose të dhënies me qira të të drejtave të përdorimit. Në rastin kur transferimi ose dhënia me qira nuk lejohet, AKEP-i merr vendim për refuzimin e kësaj të drejte.

Neni 7 **Njoftimi zyrtar**

1. Me marrjen e përgjigjes nga AKEP-i për lejimin e transferimit apo të dhënies me qira të të drejtave të përdorimit, sipas nenit 6 të kësaj rregulloreje, palët e interesuara kanë të drejtë të paraqesin në AKEP një njoftim zyrtar për transferimin ose dhënien me qira.

2. Njoftimi zyrtar bëhet i përbashkët dhe përmban informacionin, si më poshtë vijon:

- a) të dhënat e plota identifikuese të palëve;
- b) të dhënat për autorizimin individual dhe brezin e frekuencës, objekt të marrëveshjes;
- c) zonën gjeografike të shërbimit dhe kapacitetet teknike të përfshira;
- ç) afatin kohor të marrëveshjes dhe natyrën e saj (transferim apo qira);
- d) përshkrimin e kushteve kontraktore, duke përfshirë përgjegjësitë teknike dhe financiare;
- dh) deklaratën mbi ndikimin e pritshëm në treg dhe përdorimin e spektrit;
- e) datën e parashikuar të hyrjes në fuqi të marrëveshjes;
- ë) deklaratën për përmbushjen e kushteve të autorizimit.

3. Njoftimi zyrtar, sipas modelit të formularit të përcaktuar në pikën 3, të nenit 5, të kësaj rregulloreje, dorëzohet në formë shkresore në zyrat qendrore të AKEP-it ose nëpërmjet shërbimit postar, e nënshkruar, e vulosur dhe e mbyllur në zarf.

4. Kërkesa për transferim ose dhënie me qira duhet të jetë e hartuar qartë, të përmbajë qëllimin e saj, të nënshkruhet e të vuloset nga kërkuuesi/it, si dhe të shoqërohet me dokumentacionin, që vërteton përmbushjen e kërkesave të pikës 2 të këtij neni.

5. Palët njoftuese, në njoftimin zyrtar të paraqitur në AKEP, specifikojnë nëse njoftimi përmban ose jo informacion konfidencial, duke dhënë arsyetimin e duhur, kur kërkohet konfidencialiteti dhe ruajtja e sekretit tregtar. Në rast dyshimi për konfidencialitetin e informacionit, AKEP-i merr vendim për ruajtjen e konfidencialitetit pasi të ketë dëgjuar e vlerësuar interesat e sipërmarrësit, që zotëron informacionin.

Neni 8 **Verifikimi paraprak i njoftimit zyrtar**

1. Me marrjen e njoftimit zyrtar, AKEP-i bën verifikimin paraprak të aplikimit brenda 5 (pesë) ditëve punë për të përcaktuar nëse kjo kërkesë kalon në fazën e vlerësimit. Në veçanti, por pa u kufizuar, AKEP-i verifikon:

- a) nëse janë dhënë të gjitha informacionet e kërkuara;
- b) që palët njoftuese kanë një autorizim individual;
- c) nëse është një transferim apo dhënie me qira e të drejtave të përdorimit të frekuencave, që zbatohet sipas kësaj rregulloreje;

ç) që përdorimi i propozuar përputhet me qëllimin/shërbimet e lejuara në një regjim të caktuar autorizimi individual ose me autorizimin e përgjithshëm për ofrimin e rrjeteve ose të shërbimeve të komunikimeve elektronike, sipas ligjit nr. 54/2024;

d) nëse janë kryer të gjitha pagesat, tarifat e radiokomunikacionit për autorizimin individual në lidhje me të drejtat e veçanta të përdorimit;

dh) që nuk ka njoftim/e apo vendime lidhur me revokimin e autorizimit individual, që i nënshtrohet transferimit ose dhënies me qira të të drejtave të përdorimit të frekuencave.

2. AKEP-i kontrollon, gjithashtu, që çdo kërkesë për konfidencialitet të trajtohet dhe të zgjidhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për ruajtjen e sekretit tregtar.

3. AKEP-i kërkon sqarime ose dokumente shtesë, nëse informacioni është i paplotë.

4. AKEP-i ka të drejtë ta refuzojë shqyrtimin deri në plotësimin e të gjitha kërkesave.

5. Nëse, në përfundim të verifikimit paraprak, AKEP-i konstaton që njoftimi është i plotë dhe në përputhje me kërkesat për lejimin e transferimit ose dhënien me qira, njofton palët për fillimin e procesit të vlerësimit brenda afatit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

Neni 9

Procedura e vlerësimit

1. AKEP-i kryen procesin e vlerësimit të aplikimit me dy faza, si më poshtë vijon:

a) Vlerësimi i fazës së parë;

b) Vlerësimi i thelluar.

2. Vlerësimi i fazës së parë fillon pas njoftimit të AKEP-it, sipas pikës 5, të nenit 8, të kësaj rregulloreje. Data e njoftimit përcakton dhe datën e fillimit të vlerësimit të fazës së parë. AKEP-i kryen vlerësimin sipas fazës së parë brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja e njoftimit zyrtar.

3. Vlerësimi i fazës së parë kryhet për të gjitha aplikimet, si për procedurën standarde dhe atë të thjeshtuar, brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të dërguar nga AKEP-i, sipas pikës 5, të nenit 8, të kësaj rregulloreje.

4. Gjatë fazës së parë të vlerësimit, AKEP-i, pasi ka shqyrtuar informacionin e dhënë për transferimin apo dhënien me qira të të drejtave të përdorimit të frekuencave, bën vlerësimin bazuar, si më poshtë:

a) nëse nga procesi do të rezultonte një shtrembërim i konkurrencës në treg për rrjetet ekzistuese dhe të reja;

b) nëse nga procesi paraqitet një rrezik i qartë që mbajtësi i ri nuk është në gjendje të përmbushë kushtet fillestare për të drejtën e përdorimit;

c) mbi përputhshmërinë me kërkesat ligjore;

ç) mbi kriterin ekonomik e konkurrues për të identifikuar nëse marrëveshja krijon pozita dominuese apo kufizon hyrjen në treg;

d) mbi kriterin që përdorimi i spektrit do të mbetet në përputhje me rregulloret ekzistuese;

dh) mbi kriterin ligjor të përputhshmërisë me detyrimet e autorizimit individual dhe me ligjin për komunikimet elektronike;

e) mbi vlerësimin nëse transaksioni krijon përqendrim të tepërt të spektrit në një operator të vetëm;

ë) mbi kontrollin e përputhjes ligjore dhe administrative;

f) mbi analizën e ndikimit në cilësinë e shërbimit dhe në konsumatorët përfundimtarë.

5. Nëse në përfundim të vlerësimit të fazës së parë AKEP-i arrin në konkluzionin që nuk ka rreziqe për shtrembërimin e konkurrencës ose nuk ka rrezik për mospërmbushje të kushteve fillestare të autorizimit individual, AKEP-i merr vendimin për miratimin e aplikimit, sipas nenit 10 të kësaj rregulloreje.

6. Vlerësimi i thelluar fillon në përfundim të vlerësimit të fazës së parë në rastet, si më poshtë:
 - a) kur vlerëson se transferimi ose dhënia me qira e të drejtave të përdorimit të frekuencave të propozuar mund të çojë në shtrembërim të konkurrencës;
 - b) kur ka dyshime që përfituesi nuk është në gjendje të përmbushë në mënyrë të qëndrueshme kushtet origjinale të autorizimit individual.
7. AKEP-i kryen vlerësimin e thelluar brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve nga përfundimi i vlerësimit të fazës së parë.
8. AKEP-i njofton me shkrim palët njoftuese lidhur me vijimin e procesit të vlerësimit të thelluar të aplikimit.
9. AKEP-i kërkon, për këtë qëllim, informacione të mëtejshme nga palët njoftuese për të ndihmuar në procesin e vlerësimit të thelluar.
10. Gjatë vlerësimit të thelluar, AKEP-i, sipas parashikimeve në pikën 4, të nenit 72, të ligjit nr. 54/2024, merr mendimin e Autoritetit të Konkurrencës në lidhje me rrezikun e dominancës dhe shtrembërimit të konkurrencës në treg.
11. AKEP-i merr mendimin e ministrit në rastin e ndryshimeve të rëndësishme të lidhura me transferimin ose dhënien me qira të të drejtave të përdorimit të frekuencave, të dhëna me konkurrim publik, sipas parashikimeve në ligjin nr. 54/2024, të cilat ndikojnë në përmbushjen e objektivave të përgjithshëm politikë, sipas pikës 1, të nenit 5, të ligjit nr. 54/2024.
12. Në përfundim të vlerësimit të thelluar dhe pas marrjes së mendimit të Autoritetit të Konkurrencës dhe, sipas rastit, dhe të ministrit, AKEP-i merr vendim për miratimin ose refuzimin e aplikimit.
13. Vendimi i arsyetuar i AKEP-it u njoftohet palëve, sipas legjislacionit në fuqi dhe publikohet në faqen zyrtare të AKEP-it.
14. Kundër vendimit të AKEP-it, palët njoftuese dhe çdo palë tjetër e interesuar kanë të drejtë të paraqesin ankim jo më vonë se 45 (dyzet e pesë) ditë nga data e njoftimit të tij.

Neni 10

Vendimmarrja e AKEP-it

1. Në përfundim të procesit të vlerësimit, AKEP-i merr vendimin, për:
 - a) miratimin e transferimit ose të dhënies me qira pa kushte;
 - b) miratimin e transferimit ose të dhënies me qira me kushte specifike;
 - c) refuzimin e transferimit ose të dhënies me qira, duke dhënë dhe arsyet e refuzimit.
2. Vendimi përfundimtar i AKEP-it lidhur me transferimin ose dhënien me qira të të drejtave të përdorimit të frekuencave përfshin një përmbledhje të informacionit, të provave dhe të parashkrimeve të shqyrtuara nga AKEP-i dhe arsyet që mbështesin atë vendim.
3. Me miratimin e transferimit ose të dhënies me qira, AKEP-i lëshon autorizimin e ri individual jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë pune nga miratimi, ku përcakton kushtet specifike për kërkesat teknike, të mbulimit, kohëzgjatjen e autorizimit, ose të dhënies me qira, detyrimet e transferuesit dhe përfituesit, si dhe detyrimet e tjera, sipas parashikimeve në ligjin nr. 54/2024, për përdorimin e frekuencave.

Neni 11

Regjistrimi i transferimit

AKEP-i mban regjistër të veçantë për autorizimet individuale dhe, me miratimin e transferimit ose të dhënies me qira të të drejtave të përdorimit të frekuencave, publikon transferimet ose dhëniet me qira të miratuara në faqen zyrtare të tij.

Neni 12
Mbikëqyrja dhe raportimi

1. AKEP-i ushtron mbikëqyrje të vazhdueshme mbi përdorimin e spektrit të transferuar ose të dhënë me qira, për të siguruar pajtueshmërinë me kushtet e autorizimit dhe vendimin e miratimit për kushtet specifike.
2. Sipërmarrësit janë të detyruar të paraqesin pranë Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare raporte periodike vjetore mbi përdorimin e frekuencave dhe efektet e marrëveshjeve në treg, si dhe në zbatim të ligjit nr. 54/2024.
3. Në rast të mosrespektimit të kushteve, AKEP-i merr masat administrative, sipas parashikimeve në ligjin nr. 54/2024.